



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I VERIFIKIMIT TE PROCESVERBALIT

Nr _____ Prot

B.Curri, më . . .2024

PROCES VERBAL

Sot me datë 29.01.2024 në orën 10:00 në sallën e Këshillit Bashkiak Tropojë u mbajt mbledhja e radhës sipas njoftimit të rendit të ditës (Nr 474 Prot datë 24.01.2024).

Në mbledhje morën pjesë në mbledhje:

-Pasi Sekretari i Këshillit konfirmoj korumin për vashdimin e mbledhjes Kryetari i Këshillit hapi mbledhjen.

1-Arber Cakraj (Kryetari), 2-Shote Bashaj, 3-Sonila Nezaj 4-Afrim Brahaj, 5-Man Doci, 6-Besjan Gjoni, 7- Arben Kernaja, 8-Imer Hoxha, 9-Arben Zeneli, 10-Granit Kurmekaj, 11-Arbjos Kovacica, 12-Vjollca Berbati, 13-Adriatik Sallahu, 14-Tahir Tahiraj, 15-Adem Dushi, 16-Shefkie Haxhiaj, 17-Rozana Ahmetaj, 18.Shkelzen Oruci. 19.Vjollca Oruci.

Sekretari i Këshillit konfirmoj korumin për vashdimin e mbledhjes.

-Kryetari i Këshillit hapi mbledhjen.

-Kryetari i Këshillit lexoj rendin e ditës.

1.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve, datë 22.12.2023.

2. Për miratimin e Ndhmës ekonomike për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Dhjetor 2023.

3.Për shpallje, „Qytetar Nderi”.

4. Për miratimin e Planit Social 2024-2026.

5. Për miratimin e listes se të pa streheve.

6. Për miratimin e bonusit të qertasë për vitin 2024.

7.Për miratimin e kriterëve dhe sistemin e pikëzimit për përfitimin nga programi i strehimit „Banesa me kosto të ulët” si dhe listat e gjithë familjeve që janë të pastrehe dhe që kanë të ardhura.

8. Për miratimin në parim të projekt - preventivave për ndërtim apo riparim ura të dëmtuara nga reshjet e shumta të jashtëzakonshme, dhe kërkesë së Ministrisë së Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile).

9.Miratimin e kërkesës së Bashkisë Tropojë, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare familjes së Z.Nezir Ukë Mulkurtaj, banor i fshatit Luzhë, Njësia Administrative Llugaj, Bashkia Tropojë për dëmtimin e Bagëtive si pasojë e reshjeve të shirave të datës 18.01.2024.

10.Miratimin e kërkesës së Bashkisë Tropojë, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare familjes së Z.Jakup Muja, banor i fshatit Vlad, Njësia Administrative Fierze, Bashkia Tropojë për dëmtimin e Bagëtive si pasojë e reshjeve të shirave të datës 18.01.2024.

11. Njohje me raportin e KLSH

12. Informacion dhe kërkesa të qytetarëve dhe të ndryshme.

- Kryetari i Këshillit A.Cakraj hedh në votim rendin e ditës, miratohet me 13 vota Pro, 1 vote

apstenim dhe 1 votë kunder.

- Për pikën e parë të rendit të ditës, Kryetari pyet nëse është mbledhur komisioni, komisioni të jetë më i sakte me procesverbalin.
- A.Dushi: Komisioni është mbledhur, hidhet ne votim pika e parë miratohet me 11 vota Pro.
- A.Sallahu: Të shkruhen gjërat konkrete dhe të ketë kuptim cdo gjë që shkruhet përderisa jemi dhe online.
- Për pikën e 2 te rendit të ditës, Kryetari pyet nëse është mbledh komisioni
- A.Sallahu: Komisioni nuk është mbledhur por listat i kemi parë.
- Shkurte Gjoka: Listat jane të njëjta përvec dy familjeve në qytet.
- A.Kërrnaja: Vetëm shtesa nuk kamë parë.
- V.Berhati: Në këshillë të vijë lista e të gjithë aplikuesve dhe të dijmë se përse nuk kanë fituar të gjithë.
- Sh.Gjoka: I nxjerr vetë sistemi fituesit.
- A.Brahaj: Duam listat e të gjithëve dhe të atyre të skualifikuarve.
- A.Zeneli: Listat janë në rregull.
- A.Dushi: Emrat nuk lexohen, të zmadhohet shkrimi.
- Kryetari hedh në votim pikën e 2-të miratohet me 16 vota Pro dhe 2 kundër.
- A.Brahaj: Janë në fondin 6% dhe janë me biznese.
- M.Doci: Problemet janë në zyra, Policia Bashkiake dhe Zyra e taksave, të shikohen të gjithë ata që kanë biznese.
- A.Sallahu: Ka biznese që punojnë te pa regjistruara dhe përfitojnë pastaj nga fondi 6%.
- I.Hoxha: Policia Bashkiake dhe zyra e taksave të japin informacion për taksiat.
- Për pikën e 3-të të rendit të ditës, Kryetari pyet nëse është mbledhur komisioni sepse janë disa kërkesa.
- S.Neza dhe Sh.Bashaj nuk kemi kundërshtime.
- I.Hoxha: Përrjashtuar 2 emrave për të gjithë jam kundër.
- A.Cakraj lexon emrat, komisioni të reflektojë.
- G. Kurmekaj: Kryetari i Bashkisë nuk ka të drejtë për Qytetarë Nderi por për mirënjohje, kam shumë respekt për emrat por nuk jam ndakord.
- S.Nezaj: Komisioni propozon të shtyhen dhe të shqyrtohen të gjithë emrat.
- Propozimi për shtyerje miratohet unanimisht.
- Për pikën e 4 të rendit të ditës.
- Sh. Gjoka: Planin e kemi derguar në email/ëhatp.
- A.Sallahu: Ne si komision e kemi shqyrtuar dhe vështë e nevojshme që të kemi një plan, është një plan i mirë por vështirë i realizueshëm.
- Sh.Oruci: A është plan i ri apo i njëjtë.
- Sh.Gjoka: Plani social është detyrim për bashkinë, pa një plan të miratuar nuk mund të aplikojmë për fonde dhe grabde e projekte.
- Sh.Oruci: Shikoj që për një telefon është 800 mij lek (te vjetra).
- Sh.Gjoka: Plani ka shumë pika, por duhet të kemi një strehe për gratë e dhunuara.
- V.Berhati: Plani social duhet të miratohet që donatorët që do të investojnë te kenë një plan.
- Kryetari hedh në votim pikën 4, miratohet me 18 vota Pro dhe 1 votë kunder (Sh.Oruci).
- Për pikën e 5 të rendit të ditës.
- A.Sallahu komisioni është mbledhur .
- A.Zeneli: Është vetëm një shtesë në listën e të pastrehëve dhe të ndryshohet titulli i projektit dhe të bëhet „Për një ndryshim...“

- Blerim Bucpapaj: Janë shtuar 10 familje të pastrehë.
- Kryetari hedh në votim, miratohet unanimitisht.
- Për pikën e 6 të rendit të ditës.
- V.Oruci: Jemi ndakord të kalojmë këtë listë.
- B.Bucpapaj: Buxheti vjen nga Ministria.
- A.Zeneli: Nga 1 deri në 56 a është kjo listë që kanë përfituar.
- B.Bucpapaj: Po.
- Kryetari hedh në votim pikën 6, miratohet 16 vota Pro dhe 1 vote kunder.
- Për pikë 7, Kryetari a është mbledhur komisioni?
- A.Sallahu: Komsioni është mbledhur.
- B.Bucpapaj: EKB Kukës ka dërguar kriteret dhe sistemin e pikëzimit dhe ka kërkuar përfshirjen e famililjeve me 1 dhe 2 anëtar dhe ka rritur vlerat e të ardhurave.
- V.Berbat: Cili është roli juaj në në përgatitjen e listave.
- A.Cakraj: A është selektuar kjo listë.
- I.Hoxha: Jam kundër për këtë pikë.
- V.Oruci: Ka persona që janë jasht shteti dhe e kanë emrin në listë.
- T.Tahiraj: Ai që është jashtë shteti të hiqet nga lista.
- I.Hoxha: Të sillen lista nga EKB dhe të votohet.
- Sh.Bashaj: Kërkoj sqarim për pikën e 3-të të këtij projekti.
- T.Tahiraj: Kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhes dhe të rregullohet.
- G.Kurmekaj: Ne thjeshtë e kalojmë në parim dhe selektimin e bën EKB, nëse kemi ndonjë të familjes nëse dhe vëllai im nuk do të votoj, të jemi transparent, të votojmë për njerzit që kanë nevoj dhe jo për biznesmenët.
- A.Cakraj: Jam ndakord që kjo liste të shkoje në EKB.
- A.Brahaj: Kriteret a janë të gatshme, pagat a janë të rifreskuara.
- V.Oruci: Ka persona që duhet hequr nga lista.
- M.Doci: Këto familje do ti blejnë banesat.
- A.Kërrnaja: Kërkoj që rifreskim të dokumentacionit.
- Sh.Oruci: Të rifreskohen pagat dhe të ribëhet lista.
- A.Dushi: Propozoj që lista të rifreskohet.
- B.Bucpapaj: Të miratohen kriteret.
- A.Zenelaj: Të zbatohet ligji se kush përfiton dhe kush jo.
- A.Cakraj: A jeni ndakord rë kalojmë vetem kriteret.
- Këshilltarët dakortësohet që të rifreskohen dokumentat.
- Për piken 8 të rendit të ditës.
- V.Oruci: Komisioni është mbledhur por nuk jemi ndakord.
- A.Cakraj: Kemi një listë të urava.
- Fatbardh Metaliaj: Për shkak të reshjeve të datës 18.01.2024 janë identifikuar dëmet në cdo njësi nga cdo Administrator. Ka rezultuar që për riparim janë 11 ura.
- V.Oruci: Kanali i Shoshanit është bërë disa her tender.
- I.Hoxha: Të vijjnë M.Vatoci dhe B.Brahaj të japin shpjegimet e duhura. Rruga në Bytyc janë dy segmente të rrezikshme dhe andej kalojnë i gjithë biznesi i Tropojës.
- A.Kërrnaja: Sa ura janë dëmtuar në total.
- F.Metaliaj: Janë të gjitha ura të dëmtuara, kam qenë prezent tek të gjitha.
- A.Dushi: Po shoh në listë në Vicolol një urë që i shërben vetem një familje (H.Madani) dhe jo urën që i shërben të gjithë lagjes Celaj.

- M.Doci: Mendoj që duhej të ishte bërë kontakt dhe me këshilltarët në zonat përkatëse, për urën në Dojan nuk është bërë kurr asgjë.
- A.Sallahu: Duhet të njoftohemi dhe ne si këshilltar.
- A.Kërrnaja: Ku ka pasur vërshime uji para kësaj date, ne kemi bërë ndërhyrje dhe privatisht.
- A.Sallahu: Ku merren leket për këto ura.
- G.Kurmekaj: Jemi këtu tju shërbejmë qytetarëve dhe të bëhet kujdes dhe të bëhet rregullimi i plotë të këtij projekti dhe të jenë prezent B.Brahaj dhe specialistat, un nuk mund të votoj.
- A.Kërrnaja: Të vijë relacion për cdo urë të dëmtuar dhe përgjegjës përkatës që të japin shpjegime.
- F.Metaliaj: Fondit i mbaron afati me datë 31.01.2024. kemi shumë pak kohë për të dërguar listat dhe nuk e di nëse fitojmë.
- Kryetari hedh në votim pikën e 8 dhe 6 vota pro nuk miratohet.
- Për pikën 9 dhe 10 dhe një projekt shtesë nga Emergjencat Civile.
- 1- Nezir Mulkurtaj 2-Jakup Muja 3- Besmir Bucaj sipas projektit shumë përkatëse.
- Hidhet në votim 14 vota Pro mirtohen.
- Për pikën 11, është vetëm njohje me raportin e KLSH-së.
- A.Kërrnaja: Duhet të njihemi me masat e marra nga Bashkia sipas rekomandimeve të raportit.
- Pwr kwrkersat e qytetarëve
- T.Tahiraj: Komisioni ka paraqitur në këshill këto propozime:
- 1.Drita Teluli 50.000 2- Aferdita Haxhijaj 100.000 3- Jurgen Gjelošhaj 200.000
- 4- Kuvend Balaj 50.000 5- Guxim Matoshi 20.000 6- Fiqirete Hajredinaj 100.000
- 7-Xhevahir Hysenaj 50.000 8- Trashegim Iberhasaj 50.000.
- Hidhet në votim miratohet 15 vota Pro.

Mbledhja mbyllet.